



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data 18.03.2023
Nr. Prot 1732

NJOFTIM

Për thirrjen e mbledhjes së KOMISIONIT RREGULLATOR

E nderuar Kryetare e Komisionit Rregullator,

Të nderuar anëtarë,

Në mbështetje të shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 19 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Komisioneri vë në lëvizje Komisionin Rregullator sa herë që paraqiten çështje të kompetencës së tij.

Ju vë në dijeni, se janë përgatitur:

1. Projektvendimi: "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 11, datë 25.3.2021, të Komisionit Rregullator, "Për mënyrën e ngritjes, organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në Qendrën e Votimit", të ndryshuar.
2. Projektvendimi: "Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 1, datë 5.12.2020, "Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së Qendrave të Votimit, dhe përgatitjen e hartës së njesisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet".

Miratimi i këtyre projektvendimeve është kompetencë e Komisionit Rregullator.

Për këtë arsye propozoj thirrjen e mbledhjes për shqyrtimin e këtyre projektvendimeve.

Bashkëlidhur do të gjeni kopje të projektvendimeve dhe relacionet shoqërues.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

